

Z. Edison Konomi ka lindur në Durrës, më 11.02.1979. Prej muajit shtator 2023, ai emërohet në postin e Kryeinspektorit në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut sipas Urdhërit të Kryeministrit nr. 113 datë 11.09.2023.

Përpara kësaj detyre, ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Ndërsa më herët, Z. Konomi ka shërbyer si Kryetar Dege pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Nga viti 2013 ka shërbyer në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me funksione te ndryshme nga ku ka një përvojë të gjatë pune.

Në muajin maj 2011 është zgjedhur deputet në Kuvendin e Shqipërisë ku ka përfaqësuar interesat e qytetarve.

Z. Konomi ka përvojë të gjatë pune dhe në Institucione Bankare.

Z. Edison Konomi ka kryer studimet e larta në Universitetin Politeknik Tiranë, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike.

Është njohës dhe folës i gjuhëve anglisht, italisht dhe greqisht.

Z. Erion Prifti ka lindur në Tiranë 16.08.1971. Prej muajit shkurt 2024, ai emërohet në postin e Drejtorit të Drejtorisë Teknike në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut me aktin e Departamentit të Administratës Publike nr.1020, datë 14.02.2024.

Përpara kësaj detyre, ai ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit dhe regjistrimit të tatimpaguesve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Z. Prifti ka përvojë të gjatë pune me funksione të ndryshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që prej vitit 2007.

Z. Erion Prifti ka përvojë të gjatë bashkëpunimi dhe raportimi pranë institucioneve të BE-së dhe institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, drejtimin e projekteve me objektiv përmirësimin e funksionimit të administratës publike në shërbim të publikut dhe bizneseve, rritjen e shkallës së transparencës ndaj tyre etj. Z. Prifti ka përvojë të gjatë pune dhe në Sektorin Privat.

Z. Erion Prifti ka kryer studimet e larta në Universitetin Buqësor, në Fakultetin e Ekonomisë Agrare.

Është njohës dhe folës i gjuhëve anglisht, italisht dhe greqisht, frengjisht, gjithashtu certifikuar si Kontabël i Miratuar.

Z. Elisgen Ndoci ka lindur në Rrëshen, më 07.04.1990. Prej muajit Janar 2022, ai emërohet në postin e Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut me aktin e Departamentit të Administratës Publike nr. 343 datë 18.01.2022.

Përpara kësaj detyre, ai ka ushtruar detyrën e Inspektorit në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Më herët, Z. Ndoci ka qënë i punësuar si Inspektor pranë Zyrës Shqipëtare për të Drejtën e Autorit.

Z. Ndoci ka përvojë pune të gjatë dhe në sektorin privat.

Z. Elisgen Ndoci ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë.

Është njohës dhe folës i gjuhëve anglisht, italisht.

Z. Neritan Frashëri ka lindur në Durrës më 30.10.1972. Prej muajit Gusht 2018, ai emërohet Drejtor në Drejtorinë e Pronësisë Intelektuale, Pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut me aktin e Departamentit të Administratës Publike nr. 6129 datë 23.08.20218.

Përpara kësaj detyre, ai ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Naftës dhe Gazit në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial nga ku ka përvojë të gjatë pune.

Më herët Z. Frashëri ka punuar pranë Zyrës Shqipëtare të Drejtave të Autorit.

Z. Frashëri ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Drejtësisë.

Është njohës dhe folës i gjuhëve anglisht, italisht, frengjisht.

INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TR

Nr	Emer Mbiemer	Pozicioni
1	Edison Konomi	Kryeinspektor
2	Erion Prifti	Drejtor
3	Neritan Frashëri	Drejtor
4	Elisgen Ndoci	Drejtor

EGUT

Kategoria e pages	Paga bruto	Paga neto
I-4	217,760	171,113
II-1	201,550	158,907
II-1	186,980	146,634
II-2	163,460	127,802